



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2211/9 prot.

Tepelenë, më 22.07.2026

V E N D I M

Nr. 54, datë 20.07.2026

PËR MIRATIMIN E MODELIT TIP TË STRUKTURAVE TË ÇMONTUESHME PËR NJËSITË TREGTARE AMBULANTE NË ZONËN TURISTIKE PËRGJATË AKSIT RRUGOR TEPELENË – UJI I FTOHTË – HORMOVË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55 dhe nenit 68 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar; Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë, si dhe në vijim të relacionit të grupit të punës nr. 2211/7 prot, datë 13.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Modelit Tip të Strukturave të Çmontueshme për Njësitë Tregtare Ambulante në zonën turistike përgjatë aksit rrugor Tepelenë – Uji i Ftohtë – Hormovë, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Bashkia Tepelenë ndjek procedurat për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerr çdo akt administrativ të nevojshëm.
3. Ngarkohen Drejtoria e Promovimit dhe Zhvillimit të Industrisë së Turizmit, Projekteve të Huaja, Diasporës dhe Emigracionit, Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Organizative, Drejtoria e Planifikimit Kontrollit Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 11 (njëmbëdhjetë) vota
Vota Pro 11 (njëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 1 (votë)
Zbardhur më datë 22.07.2026

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

NË MUNGESË ME POROSI

N/KRYETAR MJAFTONI ZERAJ